



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:158411
Datë: 08.08.2023
Numri i dokumentit: 04565662

AC.nr.4658/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Faton Ademi antarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit–propozuesit M.M., me vendbanim në N., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F. Sh., avokat në Prishtinë, kundër të paditurve–kundërshtarëve të sigurimit M. Sh., R. H., M. B., dhe S. S., nga fshati B., Komuna P., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson V. A. – H., avokate në P., me objekt kontesti, lirim i pronës nga sendet dhe njerëzit dhe kompensimi i fitimit të humbur, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga propozuesi i masës së sigurimit M. M., përmes të autorizuarit të tij, avokat F.Sh. nga P., kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.3773/22 i dt.20.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt **08.08.2023** nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e propozuesit –paditësit M. M. me vendbanim në N./S., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat F. Sh. nga P., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.3773/22, i dt: 20.04.2023, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, me numër C.nr.3773/22, të dt:20.04.2023, ka vendosë si në vijim:

REFUZOHET i pabazuar propozimi i paditësit-propozuesit M. M., me vendbanim në N., përmes së cilit ka kërkuar që të **CAKTOHET** masa e sigurimit me të cilën i ndalohe kundërshtarëve të sigurimit M. Sh., R. H., M. B., dhe S. S., qasja, dhënia me qira, ndryshimi i

gjendjes aktuale të pronës dhe shtëpive, disponimi me paluajtshmëritë që evidentohen si ngastra kadastrale me numër P-71914021-00563-1, në sipërfaqe 824m², P -71914021-00563-2, në sipërfaqe 637m², P -71914021-00563-3, në sipërfaqe 493m², dhe P -71914021-00563- 4, në sipërfaqe 380m², vendi i quajtur “Vreshta”, Zona Kadastrale Bardhosh, Komuna Prishtinë, dhe të bëhet lirimi nga sendet dhe njerëzit i objektit/shtëpive të ndërtuara në këto ngastra, deri në vendosjen meritore të kësaj çështje.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar propozuesi i masës së sigurimit-paditësi M. M. me vendbanim në N./S., përmes të autorizuarit të tij, avokat F.Sh. nga P., shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e propozueses së masës së sigurimit, të ndryshohet aktvendimi i kundërshtuar me ankesë, duke e aprovuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit, apo të njëjtin aktvendim ta prish dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë, nuk është ushtruar nga kundërshtarët e masës së sigurimit M. Sh., R. H., M. B., dhe S. S., nga fshati B., Komuna P..

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të ankesës, analizimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, konstatoi se:

Ankesa e propozuesit të masës së sigurimit-paditësit M. M. me vendbanim në N./S., ushtruar përmes të autorizuarit të tij, avokat F.Sh. nga P., rezulton e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se propozuesi i masës së sigurimit M. M. me vendbanim në N./S., përmes të autorizuarit të tij, avokat F. Sh. nga P., me datën 10.11.2022, ka ushtruar propozim për caktimin e masës së sigurimit dhe me parashtrësën e dorëzuar me shkrim në gjykatë me datën 27.01.2023, ka kërkuar zgjerimin objektiv dhe subjektiv të propozimit, ashtu që si kundërshtar i masës së sigurimit përveç M. Sh., R. H., M. B., të përfshihet edhe S. S., me adresë në U./P., si dhe në aspektin objektiv të aprovohet propozimi dhe të caktohet masa e sigurimit në ngastrat lëndore P-71914021-00563-1, në sipërfaqe 824m², P -71914021-00563-2, në sipërfaqe 637m², P -71914021-00563-3, në sipërfaqe 493m², dhe P -71914021-00563- 4, në sipërfaqe 380m², vendi i quajtur “Vreshta”, Zona Kadastrale Bardhosh, Komuna Prishtinë, të cilat tani evidentohen në emër të kundërshtarëve të masës së sigurimit, të cilën parashtrësë, gjykata ia ka lejuar me aktvendimin e datës 07.02.2023.

Kundërshtarët e masës së sigurimit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim ndaj propozimit për caktimin e masës së sigurimit të zgjëruar në aspektin objektiv dhe subjektiv, përmes të autorizuarës së tyre, avokate V.A. H. nga P., në tërësi e kanë kundërshtuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit si atë fillestar ashtu edhe propozimin e precizuar në aspektin subjektiv dhe objektiv, me arsyetimin se kundërshtarët e masës së sigurimit në procedurën gjyqësore sipas parashtrësës së ushtruar në cilësinë e ndërhyrësve kryesor, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1482/12, të datës 14.07.2021, i plotfuqishëm që nga data 29.09.2021 ishin shpallë pronar të ngastrës lëndore 563-0, dhe atë me sipërfaqet si në vijim:

kundërshtari i parë i masës M. Sh. i sipërfaqes së ngastrës lëndore 563-0, me sipërfaqe prej 637 m², R. H. i ngastrës lëndore 563-0, me sipërfaqe prej 380 m², M. B. i ngastrës lëndore 563-0 me sipërfaqe prej 824 m² dhe S. S. i ngastrës lëndore 563-0, i sipërfaqes prej 493 m², ku ngastrat lëndore me rastin e parcelizimit nga parcela bazë 563-0, me rastin e ndarjes në katër pjese kishin marrë numra të rinjë dhe atë ngastra 563-1, me sipërfaqe prej 824 m², ngastra lëndore, 563-2 me sipërfaqe prej 637 m², ngastra lëndore 563-3 me sipërfaqe prej 493 m², dhe ngastra lëndore 563-4 me sipërfaqe prej 380 m², ashtu që, kundërshtarët e masës së sigurimit edhe janë rexhistruar në evidencat kadastrale si pronar të këtyre ngastrave, ngase këto ngastra të njëjti i kishin blerë gjatë viteve 200-2004 nga i ndjeri B. V. dhe për të njëjtat kishin paguar çmimin kontraktues dhe kishin hyrë në posedim, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, kundërshtarët e masës së sigurimit kanë propozuar që propozimi për caktim të masës së sigurimit të refuzohet i pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas zhvillimit të procedurës lidhur me caktimin e masës së sigurimit, nxjerrjes dhe administrimit të provave, me aktvendimin e ankimuar ka vendosur për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të tij.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka theksuar se

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuse fakti se kundërshtarët e sigurimit janë në posedim të ngastrave për të cilat është propozuar që të caktohet masa e sigurimit, dhe se ky fakt ishte konstatuar edhe me ekspertizën e gjeodezisë të datës 02.12.2020, të përpiluar nga eksperti Qemajl Hoda, e cila ekspertisë ishte nxjerr si provë në lëndën C.nr.1482/12.

Nga historiati me numër të referencës 11-030/04-0021709/23, i datës 30.01.2023, i lëshuar nga Zyra për Kadastër e Komunës së Prishtinës, rezulton se parcela kadastrale me nr.563-0 ZK, Nëntë Jugoviq, Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme 2334 m² para vitit 1999, sipas programit të quajtur bormën ka qenë në emër të V.M.. Me datë 30.01.2001, kjo parcelë ka kaluar në emër të M. M., duke u bazuar në kontratën për mbajtjen e përhjetshme vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë me nr. R.br. 986/73. Sipas aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr. 011-940/01-0057654/22, datë 18.03.2022, parcela nr.563-0, është perealizuar dhe janë krijuar parcelat kadastrale nr. 563-1, 563-2, 563-3 dhe 563-4. Sipas aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit nr.011-940/01-0057654/22, parcela kadastrale nr. 563-1 ka kaluar në emër të M. B., parcela kadastrale nr.563-2, në emër të M. Sh., parcela kadastrale nr.536-3 në emër të S. S., dhe parcela kadastrale nr. 563-4 në emër të R.H., duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 1482/12, datë 10.08.2021.

Me nenin 297 të LPK-së, është paraparë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Ndërsa në nenin 304.3 të LPK-së, është paraparë se

“Propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që këto “mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”.

Sipas dispozitës së lartcekur për caktimin e masës së sigurimit duhet që në mënyrë komulative të plotësohen dy kushte që propozuesi i sigurimit të bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës.

Nga kjo rrjedhë se caktimi i masës së sigurimit ka për qëllim sigurimin e kërkesës kryesore në rastet kur propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës palës paditëse. Duke i marrë për bazë provat të cilat janë në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se propozuesi i sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive në shkallën për të cilën kërkohet në mënyrë që të caktohet masa e sigurimit. Kjo për faktin se propozuesi i sigurimit përmes padisë ka kërkuar lirim dhe pronës nga sendet dhe njerëzit, si dhe kompensimin e fitimit të humbur, ndërsa nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës rezulton së pronar të ngastrave ndaj të cilave është propozuar që të caktohet masa e sigurimit janë kundërshtarët e sigurimit të cilët pronësinë në këto ngastra e kanë fituar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1482/12, të datës 14.07.2021. Edhe pse në bazë të histeriatit rezulton së këtu propozuesi M. M., nga data 30.01.2001, ka qenë i evidentuar si pronar i ngastrës 563-0, duke u bazuar në kontratën për mbajtjen e përrjetshme vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë me nr. R.br. 986/73, gjykata vlerëson së propozuesi në këtë rast nuk e ka bërë të besueshëm të drejtën subjektive, duke marrë parasysh faktin së kjo ngastër me vonë është parcelizuar dhe nga kjo janë krijuar ngastrat kadastrale nr. 563-1, 563-2, 563-3 dhe 563-4, në të cilat kundërshtarët e sigurimit e kanë fituar të drejtën e pronësisë sipas aktgjykimit të cekur me sipër.

Sipas vlerësimit të gjykatës ekzistimi i kërkesës apo të drejtës subjektive duhet të vlerësohet në kuadër të kërkesës kryesor pasi që e njëjta nuk mund të interpretohet krejt shkëputur nga kërkesa kryesore që kërkohet që të sigurohet me masë të sigurimit, andaj duke marrë parasysh faktin së këtu propozuesi me kërkesën kryesore nuk është duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë, por lirim dhe pronës nga njerëzit dhe sendet dhe kompensimin e fitimit të humbur, gjykata vlerëson së propozuesi i sigurimit në këtë rast nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive dhe pa plotësimin e këtij kushti nuk mund të caktohet masa e sigurimit.

Për më tepër, caktimi i masës së sigurimit ashtu siç është kërkuar nga ana e propozuesit të sigurimit nuk do të kishte për efekt sigurimin e kërkesës kryesore siç edhe është qëllimi i masës, por me caktimin e kësaj mase do të bëhej zgjidhja çështjes kryesore, pasi që njëra nga kërkesat e padisë është lrimi nga njerëzit dhe sendet i parcelave kontestuese dhe i objekteve/shtëpive të ndërtuara në këto ngastra, që është kërkuar edhe me masë të sigurimit.

Gjykata vë në dukje se vendosja për masën e sigurimit të kërkesëpadisë, nuk ka të bëjë me vendosjen përfundimtare të çështjes kontestuese, dhe nuk është bërë vlerësimi i fakteve në atë mënyrë që në ndonjë mënyrë mund të aludonte në mënyrën e vendosjes përfundimtare, porse në këtë fazë gjykata mbështet në dy kushtet e vëna nga neni 297 i LPK-së, që ka të bëjë me bërjen të besueshme të së drejtës subjektive (297.1 pika a), dhe kushti tjetër që ka të bëjë me rrezikun se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte e dukshëm realizimin e kërkesës (neni 297.1 pika b).

Gjykata e ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të propozuesit të sigurimit për marrjen e provës me dëgjimin e propozuesit dhe kundërshtarëve të sigurimit në cilësi të palës, dhe me dëgjimin e dëshmitarëve R. M., S. M., dhe S. M., pasi që rrethanat për të cilët janë propozuar që të dëgjohen kanë pasur për qëllim vërtetimin e fakteve lidhur me posedimin dhe shitjen e ngastrës kontestuese të cilat fakte janë vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1482/12, të 14.07.2021, i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datë 29.09.2021.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje, vlerëson se përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se aktvendimi i atakuar nuk është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, i njëjti aktvendim nuk është i shoqëruar as me shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese nga neni 182, par.2, pika (n), në lidhje me nenin 160, par.4 dhe 5 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht në rastin konkret.

Gjykata e Apelit, nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ngase nga shkresat e lëndës dhe atë Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1482/12, të datës 14.07.2021, i plotfuqishëm që nga data 29.09.2021, ku palë ndërgjyëse ishte edhe propozuesi i masës së sigurimit M. M. i përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm avokat A. Gj. nga P., kundërshtarët e masës së sigurimit M. Sh., R. H., M. B., dhe S.S., nga fshati Bardhosh, Komuna Prishtinë ishin shpallë dhe rexhistruar në evidencat kadastrale si pronar të ngastrës lëndore 563-0, dhe atë kundërshtari i parë i masës M. Sh. i sipërfaqes së ngastrës lëndore 563-1, me sipërfaqe prej 637 m², R. H. i ngastrës lëndore 563-2, me sipërfaqe prej 380 m², M. B. i ngastrës lëndore 563-3 me sipërfaqe prej 824 m² dhe S.S. i ngastrës lëndore 563-4, i sipërfaqes prej 493 m², dhe pas parcelizimit të kësaj ngastre e njëjta kishte marrë numra të rinjë të përshkruar më specifikisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ashtu që, sipas titullit juridik nga i cili kundërshtarët e masës së sigurimit kishin fituar të drejtën e pronësisë, konstatohet se të njëjtit ngastrën lëndore 563-0, e kishin blerë mbi bazën e transaksionit jo formal nga i ndjeri B. V. ish nga fshati Bardhosh (Nëntë Jugoviç) në Prishtinë gjatë viteve 2000 deri në 2004, ku i ndjeri Be. V. këtë ngastër lëndore e kishte blerë përmes transaksionit jo formal nga babai i propozuesit të masës së sigurimit V. M. në vitin 1981 dhe ishte në posedim të ngastrës lëndore, ndërsa që nga viti 2004 e tutje në posedim të kësaj ngastre lëndore ishin kundërshtarët e masës së sigurimit, dhe në të njëjtën ngastër lëndore përkatësisht në ngastrat tani të parcelizuara nga ngastra lëndore kanë të ndërtuara shtëpi individuale të banimit.

Për Gjykatën e Apelit, rezultojnë të pa bazuara pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës së i njëjti është pronar juridik i ngastrës lëndore dhe se kundërshtarët e masës së sigurimit nuk kanë të drejtën e pronësisë mbi këto ngastra, apo se të njëjtit me vet faktin se janë të evidentuar si pronar juridik të ngastrës lëndore 563-0, tani e parcelizuar nga kundërshtarët e masës së

sigurimit të njëjtit ngastrat lëndore që evidentohen në emër të tyre mund ti shesin, tjetërsojnë apo ngarkojnë me ndonjë barrë, ngase nga shkresat e lëndës dhe gjatë tërë procedurës siguroese të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë, me asnjë provë nuk është vërtetuar fakti i pretenduar nga propozuesi i masës së sigurimit se kundërshtarët e masës së sigurimit pas bartjes së të drejtës së pronësisë sipas titullit juridik aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1482/12, të datës 14.07.2021, i plotfuqishëm që nga data 29.09.2021, dhe zbatimit të të njëjtit në evidencat kadastrale, kanë ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të shitjes, ndërrimit, tjetërsimit apo ngarkimit me barrë të ngastrës lëndore 563-0, apo ngastrave të parcelizuara nga ngastra bazë 563-0, dhe atë ngastrës lëndore 563-1, me sipërfaqe prej 637 m², ngastrës lëndore 563-2, me sipërfaqe prej 380 m², ngastrës lëndore 563-3 me sipërfaqe prej 824 m² dhe ngastrës lëndore 563-4, i sipërfaqes prej 493 m², gjegjësisht nuk është provuar se të njëjtit kanë negociuar apo kanë hyrë në ndonjë raport kontraktues me ndonjë subjekt të tretë për tjetërsimin, ndërrimin, shitjen apo ngarkimin me barrë të ngastrave titullarë të të cilave janë shpallë, sepse edhe nga ekspertiza e ekspertit gjeodet Q. H. e datës 02.12.2020, e cila ishte nxjerrë si provë në lëndën kontestimore sipas numrit C.nr.1482/12, është konstatuar se kundërshtarët e masës së sigurimit në parcelat lëndore janë posedues faktik të tyre, në të njëjtat parcela kanë të ndërtuara shtëpi banimi dhe objekte tjera përcjellëse, kanë të mbjella pemë dhe se në të njëjtat shtëpi banimi edhe jetojnë, dhe mbi bazën e kësaj gjendje, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e nenit 297 pika a) dhe b) të LPK-së, drejtë ka vepruar kur ka refuzuar propozimin për masë të sigurimit, ngase propozuesi i masës nuk ka arritur të bëjë të besueshëm propozimin e ushtruar, sepse i njëjti edhe pse është evidentuar titullar i ngastrës lëndore 563-0, me sipërfaqe prej 2334 m² deri në vitin 2022 mbi bazën e punës juridike-kontratës mbi mbajtjen e përfundimeve me të ndjerin V. M., të legalizuar sipas numrit R.br986/73 në ish Gjykatën Komunale në Prishtinë, nisur nga gjendja aktuale e provave në shkresat e lëndës, nuk ekziston asnjë dyshim se kundërshtarët e masës së sigurimit pas evidentimit të tyre si pronar të ngastrës lëndore pjesët e parcelizuara dhe të bartura në emër të tyre do ti tjetërsojnë, shesin apo ngarkojnë me ndonjë barrë apo detyrim nga subjektet e treta, ashtu që, gjendja eksizutese kadastrale sipas shkresave në lëndë nuk ka rrezik të ndryshohet dhe ti pamundësohet propozuesit të masës që përmes padisë së tij të vërtetoj ekzistimin e të drejtës së tij subjektive në raport me ngastrat tani lëndore të përshkruara në dispozitiv të aktvendimit të atakuar me ankesë, dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se me mos caktimin e masës së sigurimit kundërshtarët e masës së sigurimit të njëjtit do ti pamundësojnë apo vështirësojnë realizimin e kërkesës së tij subjektive të pretenduar me kërkesëpadi, prandaj, nisur nga kjo, gjykata e shkallës së dytë, ashtu sikurse konstatimi i gjykatës së shkallës së parë, vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet themelore të përcaktura në nenin 297, pika a) dhe b), në lidhje me nenin 304, par.3 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurimit në rastin konkret, së paku këto kushte tani për tani nuk janë provuar se janë të plotësuara, prandaj, edhe pretendimet e të autorizuarit të parashtruesit të ankesës avokat F. Sh. se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk ka arsyetuar refuzimin e kërkesës, është i pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e atakuar me ankesë në përmbajtjen e tij ka dhënë arsyet të qarta dhe bindëse që qojnë në pa bazueshmërinë e propozimit për caktimin e masës së sigurimit me mos provimin e plotësimin të kushteve të përcaktuara nga neni 297, pika a) dhe b) në lidhje me nenin 304, par.3 të LPK-së, të cilat me plotësimin kumulativ të tyre rezultojnë në ruajtjen e gjendjes ekzistuese juridike, derisa të vërtetohen pretendimet sipas kërkesëpadisë së ushtruar, nuk është provuar bazueshmëria e propozimit për caktimin e masës së sigurimit, andaj, edhe në rastin konkret drejtë është vepruar nga gjykata e shkallës së parë, sepse nuk ka mos përputhje në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktvendimit të goditur me ankesë, të njëjtit janë në harmoni të plotë dhe në përputhje me nenin 160 par.4 dhe 5 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të ushtruesit të ankesës, mirëpo, të njëjtat më tepër rezultuan se kishin të bëjnë me dështimin e gjykatës së shkallës së parë që të

arsyetoj vendimmarrjen si në dispozitiv të aktvendimit të goditur me ankesë dhe referim në detyrimin e gjykatave të rregullta që të arsyetojnë vendimet e tyre sipas përfundimeve kushtetuese që janë dhënë nga Gjykata Kushtetuese, e të cilat gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm faktet që kanë rezultuar në dështimin e propozuesit për të bërë të besueshëm propozimin për caktimin e masës së sigurimit në rastin konkret, andaj, pretendimet në fjalë nuk është e nevojshme të arsyetohen më hollësisht.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e arsyeve të lartcekura, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4658/23, dt: 08.08.2023

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka